




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 03.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të dt. **28.03.2024** të parashtruar nga: “Grup i Operatorëve Ekonomik Zemrae Nuha B.I.; Qerim Bega B.I. Rr. e Manastircit - Ferizaj, MANASTIRCË lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pako ushqimore për familjet skamnore-DSHMS (Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale) Gjilan. me nr. identifikues 651-24-1194-1-2-1 dhe me numër të brendshëm të prokurimit: GL 651 24 09 121 nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** e pabazuar Kërkesa për Rishqyrtim e “ Grup i Operatorëve Ekonomik Zemrae Nuha B.I.; Qerim Bega B.I. Rr. e Manastircit - Ferizaj, MANASTIRCË “lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pako ushqimore për familjet skamnore-DSHMS (Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale) Gjilan “ me nr. identifikues 651-24-1194-1-2-1 dhe me numër të brendshëm të prokurimit: GL 651 24 09 121 , inicuar nga AK Komuna e Gjilanit.
- II. **VËRTETOHET** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i dt. 27.03.2024 për aktivitetin e prokurimit “ “Furnizim me pako ushqimore për familjet skamnore-DSHMS (Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale) Gjilan” me nr. identifikues 651-24-1194-1-2-1 dhe me numër të brendshëm të prokurimit: GL 651 24 09 121 , dhe AK – Komuna e Gjilanit vendsosë të vazhdojë më tutje me procedurën e prokurimit të përcaktuar si në pikën një dhe dy të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** “Grup i Operatorëve Ekonomik Zemrae Nuha B.I.; Qerim Bega B.I. Rr. e Manastircit - Ferizaj, MANASTIRCË “si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ar sy e t i m

“Grup i Operatorëve Ekonomik Zemrae Nuha B.I.; Qerim Bega B.I. Rr. e Manastircit - Ferizaj, MANASTIRCË” ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pako ushqimore për familjet skamnore-DSHMS (Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale) Gjilan “ me nr. identifikues 651-24-1194-1-2-1 dhe me numër të brendshëm të prokurimit: GL 651 24 09 121 . Autoriteti Kontraktues me datë 03.04.2024 ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga “Grup i Operatorëve Ekonomik Zemrae Nuha B.I.; Qerim Bega B.I. Rr. e Manastircit - Ferizaj, MANASTIRCË” Autoriteti Kontraktues - Kuvendi Komunal Gjilan ka konstatuar se pretendimet e juaja janë të pa bazuara pasi që:

Sipas pretendimit ankimor

Me dt 27.03.2024 është marr një vendim nga AK-Komuna e Gjilanit për procedurë e prokurimit me nr 651-24-1194-1-2-1 , me të cilin vendim është shpall fitues Dauti Commerc.

Por ankesa jone është se në vendimin e Tenderuesit të suksesshem keni vendos vlera të ofertueseve ndryshe nga ajo që keni paraqit në procesverbal të dt. 13.03.2024., dmth është fjala për OE EUROTEK SHPK dhe SWET BAKERY SHPK Shqetësimi yne është se: A e keni analizuar operatorin për zgjedhjes për ofertë jonormalisht të ulët, pastaj dyshimi behet edhe me permbajtësor kur ju vet keni ulë vlerat totale të dy ofertueseve të cekut me lart. Në parfaqësuesit e grupit të operatorëve ZEMRAE NUHA B.I. dhe QERIM BEGA B.I. Kerkojme të behet një rishqyrtim (rivlerësim)

Përgjigjia e AK lidhur me këto pretendim është se:

Pretendimi i OE ankuese “Grup i Operatorëve Ekonomik Zemrae Nuha B.I.; Qerim Bega B.I. Rr. e Manastircit - Ferizaj, MANASTIRCË” janë të pa bazuar sepse Njoftimi mbi vendimin e Ak është i drejtë dhe i rrjedhimisht i ligjshëm në pajtimin me të gjitha dispozitat perkatëse të LPP dhe legjislacionit të prokurimit publik

Konstatimet e AK bazuar në fakte dhe rethanat e rastit

Pretendimi juaj të lartë cekura me lartë pasi që

Në Njoftimin e Autoritet Kontraktues se datës 27.03.2024 tek Operatorët ekonomik “Sweet Bakery sh.p.k” dhe “Eurotec sh.p.k” ku cmimet sipas procesverbali i hapjes së ofertave kanë cen të vendosura Cmimi pa Tvsh që për OE “ Sweet Bakery “ – cmimin e pa tvsh 36,484.99€ dhe për OE “Eurotec sh.p.k” me cmimin pa tvsh 41,313.56€

Ndërsa , Njoftimim mbi vendimi e Autoritetin kontraktues –Version i korigjuar ku është cek po i njëjti cmimi pa Tvsh po të njëjtat që janë të paraqitura edhe në ofertën e tyre si dhe Cmimi i ofertuar me TVSH ku janë të njëjta dhe në formularin për dorëzimin e ofertave

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave pa -TVSH	Vlera totale e ofertave me TVSH
-----	--	----------------------------------	---------------------------------

1.	Dauti Komerc SH.P.K.Gërllicë, Ferizaj 810655524	28,290.00€	33,382.50€
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik Zemrae Nuha B.I.; Qerim Bega B.I. Rr. e Manastircit - Ferizaj, MANASTIRCË	32,783.40€	37,770.00€
3	SWEET Bakery SH.P.K.Ali Hadri, Prizren 812021525	36,484.99€	43,050.00€
4.	" EUROTEC " SH.P.K. Nto 99/21, Gjilan 810081349	41,313.56€	48,750.00€

Autoriteti Kontraktues konstaton se ky pretendim ankimor OE se " A e keni analizu operatorin perzgjedhes per ofert jonormalisht te ulet," është i pa bazuar, pa fakte dhe nuk qëndron pasi që:

Autoritet kontraktues –përmes tables vlersimin e tenderve –Jo normalisht te ulët dhe operatorve te pergjegjeshme sipas Dosjes se tenderi ka vlersuar dhe ka konstatuar se OE i rekomanduar i me kontrat nuk ka ofertuar me çmimin Jo- Normalisht të ulët .

Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi ka trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminime ka vepruarë në mënyrë transparente.

1. Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 59 të LPP-së, ka bërë ekzaminim, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, dhe sipas kritereve të përcaktuara në FDT dhe Njoftimin për kontratë në harmoni me Nenin 60 Kriteret për Dhënie e Kontratës ka marrë vendim me ta shpërblyer me kontratë publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës.